



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 149, datë 05.05.2020**

**MBI**

**MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDEVE TË LIRA, NGA BUXHETI I VITIT 2020,  
NË SISTEMIN GJYQËSOR, SIPAS AKTIT NORMATIV NR.15/2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, date 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave, Aktit Normativ nr.15/2020, si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 19 000 000 lekë, në artikullin shpenzime personeli (*sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur*).
2. Miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, për shumën prej 60 000 000 lekë, në artikullin shpenzime personeli (*sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur*) dhe në shumën 30 000 000 lekë, në artikullin shpenzime operative (*sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur*).
3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**